



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 6.3.2020

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 6.3.2020, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 162, datë 19.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Manjola Kajana

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 22.7.2019, është njoftuar vendimi nr.162, datë 19.6.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit znj. Manjola Kajana, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, kandidate për prokurore në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pas verifikimit të situatës faktike, analizës dhe vlerësimit të provave dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i Komisionit, nisur nga rëndësia e veçantë e pozicionit të prokurorit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK, në përmbushjen e misionit të rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, çmon se vendimi nr. 162/2019 përmban shkaqe për t’iu nënshtruar juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Apelit.

Për efekt të këtij gjykimi, Komisioneri Publik parashtron në vijim mungesën e hetimit mbi rrethana të tilla dhe fakte ligjore, si: (i) gjendja e mundshme e konfliktit të interesit midis subjektit

të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokurorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar); **(ii)** ligjshmëria e aplikimit të përfitimit të statusit si i pastrehë, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (të ndryshuar), në raport me integritetin e subjektit, në përmbushje me standardet më të larta etike, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën private; **(iii)** deklaratimet e pasakta dhe kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në plotësimin e *Deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pjesa 2*, si dhe deklarimeve të vetë subjektit, mbi historikun e vendbanimit dhe vendqëndrimit të saj dhe familjes; si dhe **(iv)** mungesë hetimi mbi çështje të tjera të lidhura me burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Komisioneri Publik, bazuar në specifikat e rrethanave të dala nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në kuptim të qëllimit të shpallur në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në zbatimin e duhur të ligjit, vlerëson se rezultatet e hetimit nga ana e Kolegjit, mbi këto rrethana të ndërthurura me njëra-tjetrën, që lidhen me të tria kriteret e rivlerësimit, eventualisht do të provonin nëse *veprimet apo mosveprimet* e subjektit të rivlerësimit kanë cenuar kriteret e vlerësimit të etikës profesionale, figurës së magjistratit apo nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ose jo burime të ligjshme të të ardhurave dhe, në vlerësim tërësor të procedurave, do të mund të vendosej mbi vlerësimin përfundimtar për konfirmimin ose jo në detyrë të saj.

I. Analiza e shkaqeve të ankimit

Konkretisht, në vijim parashtrojmë arsyetimin për rrethanat dhe faktet ligjore që kanë nevojë për hetim të mëtejshëm:

1. Evidentimi i gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokurorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar).

1.1 Komisioneri Publik, gjatë trajtimit të vendimit nr. 84/2018, të Komisionit, për një tjetër subjekt rivlerësimi, është njohur me aktet procedurale lidhur me kallëzimin e disa qytetarëve të Bashkisë Fier, për paligjshmëri në ushtrimin e detyrës nga funksionarë bashkiakë të Bashkisë Fier, gjatë dhënies së kredive të buta (lehtësuese) për familje të pastreha, akte me të cilat është njohur dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në gjykimin e ankimit ndaj këtij vendimi, për të cilin është marrë vendimi përfundimtar (JR) nr. 2/2020.

1.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të vendimit të sipërcituar, ashtu siç është trajtuar edhe në ankimin përkatës të Komisionerit Publik, në fillim të muajit korrik 2012, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezultoi të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. ***/2012, kallëzim i paraqitur nga një grup qytetarësh të pastrehë të Bashkisë Fier, të cilët

pretendonin kryerjen e veprimeve të paligjshme nga ana e funksionarëve të Bashkisë Fier në dhënien e kredive lehtësuese, subjekteve që nuk plotësonin kriteret për t'u trajtuar me këto kredi.

1.3 Duke iu referuar të njëjtave akte procedurale, rezulton se pas regjistrimit të këtij kallëzimi, me vendimin e datës ****.7.2012*, organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për këtë kallëzim të regjistruar nga organi procedues. Qytetarët e pastrehë, në cilësinë e kallëzuesve e kanë ankimuar vendimin e organit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo e fundit, më datë ****.2.2013*¹, duke arsyetuar ndër të tjera se: *“[...] Në hipotezë të provimit të pretendimeve të kërkuësve, gjykata çmon të tërheqë vëmendjen se kundërligjshmëria në të gjithë procedurën që është finalizuar me marrjen e vendimit të Këshillit Bashkiak, është flagrante, e që nuk kufizohet në kuadrin e një zgjidhje administrative, por që përmban elementët e figurave të veprave penale, shpërdorimit të detyrës apo edhe të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, të parashikuara nga nenet 248 e 186 të K. Penal.[...]”*, ka prishur vendimin e Prokurorisë Fier, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve në lidhje me verifikimin e kallëzimit nr. ****/2012*.

1.4 Ndërkohë që vendimi i mëparshëm i Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal ishte në fazën e shqyrtimit gjyqësor, më datë ****.10.2012*, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kishte urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *****, për veprën penale “Shpërdorim të detyrës”, kryer në bashkëpunim, dhe veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, për fakte të njëjta, në ngarkim të zyrtarëve të Bashkisë Fier. Procedim ky i fundit, që pas marrjes së vendimit të lartpërmendur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, është bashkuar me atë të kallëzimit të korrikut 2012, në një procedim të vetëm.

1.5 Për këto procedime penale, veprimet hetimore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë shtrirë gjatë harkut kohor 2012 - 2014, ku përfundimisht procedimi penal nr. *****, i vitit 2012, është dërguar për gjykim, duke kërkuar gjykimin e disa subjekteve, funksionarë dhe nëpunës publikë, për kryerjen e veprave penale “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikim i dokumenteve”.

1.6 Në të njëjtën kohë, kur organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kishte në hetim të njëjtët funksionarë të strukturave të Bashkisë Fier për kryerjen e veprave penale “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikim i dokumenteve”, funksionarë të organit procedues, aplikojnë, shpallen fitues të skemës për përfitimin e kredive të buta, si dhe u disbursohet kjo kredi e butë.

1.7 Kjo periudhë përkon me kohën² gjatë së cilës edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit, rezulton se ka ndjekur procedurat administrative dhe është përfshirë në listën e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Fier për përfitimin nga programi social i strehimit (kredi e butë), ndërsa subjekti i rivlerësimit kryente funksionet e prokurores pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹ Referohuni vendimit nr. ****-2013-****, datë ****.2.2013*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, aksesuar nga përmbajtja e portalit publik: www.gjykata.gov.al, të administruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë.

² Referohuni shkresës nr. ***** prot., datë ****.6.2019*, të Bashkisë Fier.

1.8 Nisur nga sa më sipër, në funksion të rivlerësimit të kriterit të etikës profesionale të magjistratit, Komisioneri Publik konstaton se Komisioni nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacion mbi gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit në kryerjen funksionin e prokurorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, që mund të përbëjë një konflikt interesi, qoftë edhe në dukje me Bashkinë Fier.

1.9 Komisioneri Publik konstaton se mbetet i pahetuar fakti nëse subjekti i rivlerësimit të ketë përfituar statusin “e pastrehë”, që rezulton se nuk mund ta përfitonte bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, për shkak të funksionit që ajo kryente në organin e Prokurorisë, që po hetonte zyrtarët e Bashkisë Fier, për të njëjtat shkelje të ligjit.

1.10 Po ashtu, referuar kontratës nr. *** prot., datë ***.3.2014, “Ndryshime në kontratën e kredisë bankare”, lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj dhe ***, rezulton se në kredinë e disbursuar më datë ***.3.2014 është aplikuar normë interesi bono thesari, normë kjo, në dukje preferenciale krahasuar me normat e interesit të aplikuara nga kjo bankë në aneksin bashkëlidhur kontratës së kredisë, së datës ***.6.2013 (bono thesari vjetore 3.8% + 2.2%). Edhe në këtë rast, nuk rezulton që Komisioni të ketë hetuar mbi gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit, në drejtim të përfitimit të kësaj norme preferenciale nga ***.

1.11 *Komisioneri Publik, sa më sipër, çmon se:* rezultatet e hetimit administrativ duhet të vlerësohen bazuar në të dhëna objektive nëse subjekti i rivlerësimit ndodhet ose jo në kushtet e konfliktit të interesit, duke verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka hetuar apo kryer veprime procedurale, në çështje lidhur me Bashkinë Fier ose zyrtarë të saj, si dhe me *** ose punonjës të saj. Këto rrethana të ndërthurura me njëra-tjetrën, eventualisht do të qartësonin nëse veprimi apo mosveprimi i subjektit të rivlerësimit ka cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit, e për rrjedhojë, besimin e publikut, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

1.12 Nisur nga ecuria e procedimit penal në ngarkim të funksionarëve të Bashkisë Fier të gjykuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikim i dokumenteve”, për nevojat eventuale të hetimit që mund të vendoset nga ky trup gjykues, Komisioneri Publik kërkon të administrohen:

1.12.1. Dosja gjyqësore penale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me vendim nr. ***, datë ***.5.2015. *(Në këtë dosje do të duhet të shqyrtohen fashikujt e Prokurorisë për kallëzimin penal nr. ***/2012, të korrikut 2012, dhe procedimin penal nr. ***/2012, për të verifikuar në rast se subjekti i rivlerësimit ka kryer ose jo veprime procedurale në hetimin e këtyre procedimeve penale.)*

1.12.2. Informacion nga Prokuroria e Përgjithshme, në rast se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës tetor 2009 - korrik 2013, kur ka shërbyer pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka qenë në cilësinë e

prokurorit të ngarkuar për shqyrtimin e materialeve kallëzuese, procedimeve dhe kërkesave për gjykim për procedime penale, ku përfshihet Banka ***.***.

2. Evidentimin e ligjshmërisë së aplikimit të përfitimit të statusit si i pastrehë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 (të ndryshuar).

2.1 Në vijim të këtyre parashtrimeve, sikundër është pretenduar në shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, nga aktet në dosje ka rezultuar se Këshilli Bashkiak i Bashkisë Fier, me vendimin nr. 46, datë 30.10.2012, ka miratuar listën emërore të familjeve të pastreha, të cilat kanë aplikuar për të përfituar kredi me kushte lehtësuese, listë në të cilën figuron edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit.

2.2 Komisioneri Publik vlerëson të nënvizojë se, referuar ligjit nr. 9232/2004, konkretisht nenit 4 të tij, rezulton se përfitojnë strehim: (i) individët që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe (ii) familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a. nuk kanë në pronësi një banesë;

b. zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike ku bëjnë pjesë këto familje ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;

c. kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

Përfshihen në njëërën nga shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1 të këtij neni, vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme.

2.3 Lidhur me parashikimin ligjor se përfituesit nuk duhet të kenë banesë në pronësi, nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit me aktin: *“Kontratë shitje përfundimtare”*, nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2012, lidhur midis Entit Kombëtar të Banesave (EKB), në cilësinë e *shitësit*, dhe vjehrrit, bashkëshortit dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e *blerësit*, ka fituar pronësinë mbi një apartament banimi në qytetin e Durrësit.

2.4 Lidhur me parashikimin ligjor se aplikuesi duhet të zotërojë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, Komisioneri Publik konstaton se referuar VKM-së nr. 814, datë 3.12.2004, *“Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”*, sipërfaqja e banesës në qytetin e Durrësit, në bashkëpronësi të vjehrrit, bashkëshortit dhe subjektit të rivlerësimit, është mbi normën e përcaktuar nga kjo VKM, në pikën 2 të saj³.

2.5 Ndërkohë, lidhur me parashikimin ligjor mbi kriterin e të ardhurave⁴, nga verifikimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se për vitin 2012, kohë kur është aplikuar dhe dorëzuar dokumentacioni justifikues për plotësimin e kriterëve, të ardhurat mesatare mujore të

³ Sipërfaqja minimale e banimit që i takon një personi të vetëm, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, është 12,5 m². Çdo person tjetër shtesë mbi të parin, me moshë mbi 10 vjeç, i takon 7,5 m² sipërfaqe banimi.

⁴ Referohuni nenit 19, pika 3, e ligjit nr. 9232/2004 (të ndryshuar) dhe lidhjes “c” bashkëlidhur, *“Mbi përcaktimin e kufirit maksimal dhe minimal të të ardhurave të familjes që përfitojnë nga banesat me kosto të ulët”*.

familjes Kajana (përfshirë edhe vjehrrin) janë në shumën rreth 232.000 lekë.⁵ Gjithashtu, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, nga të dhënat e sistemit bankar, rezulton se balanca (gjendje) e llogarive bankare të tyre në datën 30.10.2012, datë që përkon me datën e vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, është në total në vlerën rreth 5.700.000 lekë.⁶

2.6 Referuar vërtetimit të punësimit të datës ***.10.2016, të lëshuar nga shoqëria “****.***.***” sh.p.k., rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga viti 2011 deri në nëntor të vitit 2012, ka qenë i punësuar në Tiranë, pranë kësaj shoqërie. Vetëm për vitin 2012, vit i cili përkon me periudhën e aplikimit nga ana e tij në cilësinë e kryefamiljarit, për kredi me kushte lehtësuese si i pastrehë, të ardhurat e tij neto janë në vlerën 9.965 euro.

2.7 Përmbushja e kriterëve ligjore për të përfituar nga programet sociale për strehim, normohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.8.2012⁷, në fuqi kur është miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier nr. 46, datë 30.10.2012. Sipas kriterëve të kësaj VKM-je, pas fazës së parë, e cila përfshin aplikimin nga ana e subjekteve që kërkojnë të përfitojnë, klasifikimin nëpërmjet sistemit të pikëzimit, seleksionimin e përfituesve, njoftimin, kalohet në fazën e dytë, ku familjet përfituese duhet të dorëzojnë dokumentacionin provues që mbështet aplikimin dhe që legjitimon përfitimin e këtij statusi⁸.

2.8 Në mungesë të administrimit nga ana e Komisionit të dokumenteve të paraqitura nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në momentin e aplikimit pranë Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier, për përfshirjen në listën e përfituesve nga programet sociale për strehim, referuar sa është administruar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, konstatohet se familja e subjektit të rivlerësimit rezulton përfituese e kësaj të drejte jashtë kriterëve ligjore.

2.9 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, se: *“...Ne nuk kemi përfituar kredinë sipas saj, si rrjedhojë, ajo nuk ka passjellë asnjë pasojë*

⁵ Të llogaritura bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë ***.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier, mbi të ardhurat e subjektit në shumën 72.495 lekë; Vërtetimin e datës ***.10.2016, i shoqërisë ***, mbi të ardhurat neto të realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për periudhën janar - nëntor 2012, në shumën 116.025 lekë (të konvertuara me kursin mesatar vjetor); Vërtetimin për bazën e tatueshme dhe pagën neto vjetore të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 43.483 lekë.

⁶ Nga korrespondenca e Komisionit me bankat rezulton shuma 2.000.000 lekë, vendosur në emër të subjektit të rivlerësimit, në bono thesari (vendosur në datën 1.8.2011 dhe rinovuar pas maturimit në datën 2.8.2012); shuma 21.005 euro ose 2.935.728 lekë (konvertuar me kursin e datës 30.10.2012), depozitë në *** Bank, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; shuma 5.546 euro ose 774.061 lekë, gjendje në llogaritë e pagës së bashkëshortit pranë *** dhe ***.

⁷ VKM e cila ka shfuqizuar VKM-në nr. 53, datë 28.1.2005, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qira”.

⁸ Ndër të tjera, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit, duhet të ketë paraqitur këto dokumente: 1. Certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare; 2. Vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit; 3. Vërtetimin e të ardhurave neto të familjes; 4. Dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune; 5. Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes; 6. Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë; 7. Vërtetimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të vendit të origjinës, se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi.

financiare apo juridike”, nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar mbi ligjshmërinë e aplikimit dhe përfitimit të kësaj kredie.

2.10 Duhet të nënvizojmë se mungesa e finalizimit të marrëdhënies së kredisë me kushte lehtësuese me interes 3%, si dhe mungesa e pasojave juridike të pretenduara, kanë qenë të pavarura nga vullneti i subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj, pasi ata vullnetin e tyre e kanë konkretizuar si me aplikimin për përfitimin e kësaj kredie, ashtu dhe me lidhjen e kontratës për përfitimin e kredisë. Vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...*Kjo kontratë nuk u ekzekutua nga ana e bankës, për shkak se siç na njoftoi banka, pas lidhjes së kontratës, Bashkia e Fierit nuk kishte më kuota në dispozicion për këtë kategori kredish*⁹”.

2.11 Pretendimet e subjektit për mungesën e pasojave juridike, nuk qëndrojnë nëse subjekti nuk do të arrinte të provonte se ka qenë në kuptimin formal në plotësim të kriterëve të parashikuara për të përfituar nga programet sociale për strehim, sipas ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 dhe VKM-së nr. 574, datë 29.8.2012, si dhe faktit se as ajo dhe bashkëshorti nuk janë përpjekur të paraqesin ndryshe rrethanat e përfitimit.

2.12 Në të kundërt mbetet e pajustificuar dhe e padrejtë në kuptimin etik, përpjekja e bashkëshortit dhe e subjektit të rivlerësimit për të përfituar një kredi me kushte lehtësuese, e ofruar për kategorinë e familjeve të pastreha, për sa kohë rezultojnë në kushte pamundësie për të siguruar një të tillë, qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apeli, në vendimin (JR) nr.15/2019, prg. 88-89¹⁰.

2.13 Në kushtet kur nga gjendja e akteve në dosje rezulton se subjekti dhe personi i lidhur nuk përmbushin kriteret e vendosura nga një akt ligjor dhe nënligjor (VKM), konstatohen shkaqe në të cilat gjen zbatim neni 61, pika 5, pasi do të rezultonte se subjekti ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, parë kjo mbi vlerat themelore dhe standardet e etikës, dhe rregullat e sjelljes së magistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016.

2.14 Ky qëndrim ka gjetur mbështetje në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, në të cilën, në raste të ngjashme, shprehet se magjistrati duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji¹¹.

⁹ Referohuni përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, në vijim të pyetjeve të Komisionit, të datës 16.5.2019.

¹⁰ Referohuni vlerësimit të Kolegjit në vendimin (JR) 15/2019, paragrafi 88 dhe 89: “[...] Në këto kushte, Kolegji çmon se edhe në kushtet kur subjekti do të arrinte të justifikohet se në kuptimin formal të kriterëve të parashikuara nga VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë dhe të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, ai nuk kishte kryer asnjë veprim me shkelje, mbetet e pajustificuar dhe e padrejtë në kuptimin etik, përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të përfituar një kredi me kushte lehtësuese, e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë e suport që shteti e ofronte për funksionarët e tij, në kushte të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare. Kjo sjellje nga Kolegji shihet jo në përputhje me praktikën e mira të njohura gjerësisht dhe të gjithëpranuara të parimeve të Bangalores mbi sjelljen e magistratit [...]; [...] Në vijim të kësaj përpjekjeje, vjen si konsekuencë edhe kryerja e disa veprimeve fiktive (ku palët nuk kanë për qëllim të sjellin pasojën juridike që shprehin se dëshirojnë), të cilat për më tepër janë fokusuar në ngritjen e një mekanizmi transaksionesh që të mundësojnë përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, ndonëse banesa për të cilën ajo kredi ishte akorduar, nuk ekzistonte dhe madje duket se as nevoja imediate e vetë subjektit për strehim [...].

¹¹ Referohuni vlerësimit të Kolegjit në vendimin (JR) 28/2019, paragrafit 45 dhe 47 pika 4: “[...] Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjyqësor vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë

2.15 Po t'i referohemi jurisprudencës të Kolegjit në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit të subjekteve të tjera, të njëjtin qëndrim do ta gjejmë të shprehur, përveç sa më sipër, edhe në vendimin (JR) nr. 22/2019, prg. 67, pika 1 dhe 2,¹² apo në vendimin e shkurtuar (JR) nr. 2/2020, prg. 3.4¹³.

2.16 Sa më sipër, në gjendjen që janë aktet në dosje, mbeten të paqarta rrethanat dhe faktet mbi dokumentacionin e paraqitur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit, për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, si i pastrehë, pasi nga dokumentacioni i administruar rezulton se nuk plotësohen kushtet e mungesës së banesës në pronësi apo një banesë nën normat e lejuara, dhe të ardhurat e tyre nuk janë në pajtueshmëri me kushtet ligjore të përfitimit të statusit si i pastrehë.

2.17 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ashtu sikurse dhe Komisioni i ka kërkuar Bashkisë Fier, por pa marrë përgjigje shteruese të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar, do t'i shërbente hetimit administrativ nëse do të *administrohej e gjithë praktika dokumentare për miratimin si përfitues i programeve sociale për strehim të z. Kajana, depozituar pranë Bashkisë Fier*, pasi në gjendjen që janë aktet, nuk mund të vlerësohet nëse subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale, etikës (neni 61/4) si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave (neni 4/2) ka cenuar etikën e magjistratit, e për rrjedhojë, besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61/5).

2.18 Për nevojat eventuale të hetimit, që mund të vendoset nga ky trup gjykues, Komisioneri Publik kërkon të administrohen:

2.18.1 Praktika e plotë dokumentare e aplikimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë Bashkisë Fier, në vlerësim të së cilës, me vendimin nr. 46, datë 30.10.2012, të Këshillit Bashkiak Fier, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit u miratua të jetë pjesë në listën emërore të familjeve të pastreha që përfitojnë kredi lehtësuese.

orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji⁶⁶. Konkretisht, në çështjen e regjistruar në Kolegj me nr. 31/2018 (JR), trupi gjykues, në vlerësimin e tij [në paragrafët nr. 29 dhe 34] për fiktivitet lidhur me çmimin e vendosur nga palët në funksion të përfitimit të një kredie, dhe lidhur me përfitimin e një prone [në paragrafin nr. 50], në kushtet kur nuk përmbusheshin kriteret e vendosura nga një akt nënligjor (VKM), ka konstatuar shkaqe në të cilat gjen zbatim neni 61, pika 5, pasi subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia për shkak të kontratave fiktive për të përfituar kredi bankare dhe për shkak të përfitimit të një pasurie në kushtet kur subjekti nuk përmbushte kriteret ligjore për përfitim[...].

¹² Referohuni vlerësimit të trupit gjykues në paragrafin 67, pikat 1 dhe 2: “[...] Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sepse: 1. subjekti nuk mund të përfitonte [...], pasi nuk plotësonte asnjë nga kriteret e legjisllacionit në fuqi të kohës [...]; 2. Subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë kryer veprime juridike fiktive, me qëllim përfitimin e kredisë bankare për blerjen e pasurisë apartament [...]”.

¹³ Referohuni vlerësimit të trupit gjykues në paragrafin 3.4: “[...] Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, etikës, si dhe vlerësimin tërësor të procedurave sa i përket praktikave të transferuara nga Komisioni pranë organeve kompetente për inspektimin e shkeljeve disiplinore, për të cilat Komisioneri Publik ka kërkuar nëpërmjet ankimit të shqyrtohen nga Kolegji: ...në lidhje me procedimin penal nr.***, i datës, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, përfshirja e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në mënyrë të padrejtë në listën e familjarëve të pastrehë të Këshillit Bashkiak Fier, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë: ... [...]”

3. Evidentimi i deklarimeve të pasakta dhe kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pjesa 2, si dhe deklarimeve të vetë subjektit, mbi historikun e vendbanimit dhe vendqëndrimit të saj dhe familjes.

3.1 Nga aktet në dosje, ashtu sikurse është trajtuar dhe në shkaqet e ankimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktë Deklaratën për Kontrollin e Figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pjesa 2, të dhëna për vendin e banimit, në rubrikën: *“Historiku i adresave të banimit nga 1.1.2012”*. Gjithashtu mbeten të paqarta lëvizjet e gjendjeve civile dhe deklarimit të banesave të subjektit të rivlerësimit, të kryera nga kjo e fundit, në funksion si të përfitimit nga privatizimi i EKB-së, për banesën në Durrës, të vjehrrit të subjektit, ashtu dhe për përfitimimin e kredisë si familje e pastrehë në qytetin e Fierit.

3.2 Evidentimi i pasaktësisë dhe i kontradiktave të këtyre deklarimeve, së bashku me rezultatet e hetimit mbi veprimet e kryera në funksion të përfitimit nga statusi i të pastrehëve, për qëllime përfitimi financiar, janë sjellje të subjektit të rivlerësimit që duhen vlerësuar në raport me detyrën, sjellje të tilla që do të duhej të konsideroheshin si të pranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit të rivlerësimit, si një funksionare e këtij sistemi¹⁴.

4. Evidentimi i mungesës së hetimit mbi çështje të tjera të lidhura me burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

4.1 (i) Mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitet 2013 - 2014

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar në DV-2013 dhe DV-2014 të ardhura nga paga pranë shoqërisë “****” sh.p.k., respektivisht në shumat 600.000 lekë për vitin 2013 dhe 150.000 lekë për vitin 2014, shuma të cilat rezultojnë të jenë depozituar në llogarinë e pagës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pranë bankës ***.***.***¹⁵.

4.1.1 Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2018, ka informuar Komisionin mbi pagat e deklaruara, palët punëdhënëse, si dhe kontributet e derdhura për efekt pensioni pleqërie për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Në informacionin e dërguar nuk ka të dhëna për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për periudhën dhjetor 2012 - maj 2015.

4.1.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit mbi këtë fakt, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“...Në muajin prill të vitit 2019, nga ana e administratorit të kësaj kompanie, na është thënë se ... ata janë përballur me një gabim njerëzor, si dhe është bërë e mundur pagesa e detyrimeve për tatimin mbi fitimin për atë periudhë. Në të njëjtën kohë na janë dorëzuar dy urdhërpagesa të “****” sh.p.k., me nr. NIPT ***; me përshkrimin ‘pagesë*

¹⁴ Referohu mendimit paralel të gjyqtarës R. Schuetz në vendimin nr. 4/2018 të KPA-së.

¹⁵ Referohuni shkresës nr. *** prot., datë ***.12.2018, e bankës ***.***.***.

kundrejt detyrimit tatimor’, ku njëri urdhër mban shumën 38.538 lekë dhe tjetri 139.008 lekë¹⁶”.

4.1.3 Bashkëngjitur këtyre shpjegimeve, subjekti ka depozituar: (i) Urdhërpagesë 1500, tatim i mbajtur në burim, periudha tatimore korrik 2015, shuma 38.538 lekë; (ii) Mandat pagese i datës 8.4.2019, që vërteton pagesën e shumës 38.538 lekë nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) Urdhërpagesë 1500, tatim i mbajtur në burim, periudha tatimore dhjetor 2014, shuma 139.008 lekë; (iv) Mandat pagese i datës 8.4.2019, që vërteton pagesën e shumës 139.008 lekë nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k.

4.1.4 Komisioni, bazuar në këto akte, ka vlerësuar se: *“Sipas kontratës individuale të depozituar rezulton se kontributet mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit do të derdreshin nga punëdhënësi. Sipas statement-it bankar, Komisioni konstatoi se pagat e bashkëshortit të subjektit në shumën 50.000 lekë ishin kaluar çdo muaj në sistemin bankar nga punëdhënësi, ndërsa u konstatua se nuk ishin paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për këtë periudhë punësimi... Në këto kushte, Komisioni i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare¹⁷”.*

4.1.5 Në vlerësim të Komisionerit Publik aktet si më sipër nuk provojnë pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga punësimi pranë kompanisë “****” sh.p.k., në konsideratë të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi:

- Në kontratën me punëdhënësin, në seksionin *“Kushtet e pagesës”*, është parashikuar detyrimi i punëdhënësit për të derdhur në llogari të punëmarrësit kuotën e përcaktuar sipas ligjit në fuqi për tatimet dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore. Nga sa më sipër analizuar, rezulton se nuk është shlyer detyrimi i punëdhënësit mbi tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas kushteve të kontratës. Si rrjedhojë dhe të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur, nga paga e tij si i punësuar, janë në masën korresponduese me shumën e deklaruar rregullisht dhe në përputhje me ligjin nga punëdhënësi kompanisë “****”, qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 7/2019, prg. 24¹⁸.

¹⁶ Referohuni shpjegimeve të subjektit, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, të datës 23.4.2019.

¹⁷ Referohuni “Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm”, faqe nr. 8, në vendimin e Komisionit.

¹⁸ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 7/2019, prg. 24: “[...] Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.5 më sipër, sa i takon kundërshtimit të subjektit për konkluzionin e Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë të të ardhurave të personit të lidhur, bashkëshortes ***.***, në deklaratën e interesave periodike/vjetore të vitit 2009, në shumën 488.896 lekë, me pretendimin se ai ka deklaruar me saktësi të ardhurat e marra në masën e përfutur faktikisht, pavarësisht se punëdhënësi ka deklaruar punësimin e bashkëshortes së tij pranë organeve tatimore me pagë minimale dhe ka shlyer detyrimet tatimore përkatëse të përllogaritura sipas kësaj page, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim provat shkresore të administruara në fashikullin gjyqësor, konstaton se në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar si të ardhura të bashkëshortes së tij vlerën prej 540.000 lekësh, ndërkohë që bashkëshortja e tij rezulton si punëmarrëse e deklaruar rregullisht dhe në përputhje me ligjin pranë punëdhënësit person fizik që ushtron aktivitet si klinikë dentare {***}, prej datës 1.7.2009 - 31.12.2009, me pagë neto mujore prej 15.184 lekësh. Për rrjedhojë, të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur, nga paga e saj si e punësuar, janë në masën 91.104 lekë dhe jo 540.000, sa rezulton të jenë deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur[...].”

- Në formularin e paraqitur për periudhën tatimore *korrik 2015*, në detajet e urdhërpagesës është specifikuar: *“Tatim mbi të ardhurat nga dividendë dhe aksione”*, dhe shuma e detyrimit e gjeneruar nga sistemi dhe e paguar më datë ****.4.2019*, i përket vetëm gjobave dhe interesave të shoqërisë ndaj organeve tatimore për këtë periudhë, për këtë zë.

- Në formularin e paraqitur për periudhën tatimore *dhjetor 2014*, në detajet e urdhërpagesës është specifikuar: *“Të tjera tatime në burim, detyrim principali”* dhe shuma e gjeneruar nga sistemi dhe e paguar më datë ****.4.2019*, nuk duket se i korrespondon detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale për pagën e përcaktuar në kontratën e punës të datës ****.1.2013*, së bashku me gjobë dhe interesa, deri në datën e gjenerimit të urdhërpagesës nga sistemi tatimor.

- Në të dyja urdhërpagesat e vëna në dispozicion, tatimi i paguar nga shoqëria në datën ****.4.2019*, rreth 6 vite me vonesë nga lindja e detyrimit, nuk korrespondon me detyrimin e shoqërisë për tatimin mbi të ardhurat personale nga paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të realizuara gjatë periudhës janar 2013 - mars 2014, as për llojin e tatimit të paguar, as për periudhën tatimore të përcaktuar në urdhërpagesë dhe as për shumën e paguar.

4.1.6 **Komisioneri Publik**, për sa më sipër dhe në zbatim të praktikës tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Apelit mbi trajtimin dhe konsiderimin si të ardhura të ligjshme, të ardhurave të cilat në mënyrë komulative rezultojnë se janë deklaruar dhe për to janë paguar detyrimet tatimore¹⁹, *vlerëson se këto të ardhura nuk duhet të llogariteshin nga ana e Komisionit si burime të ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, pasi nuk plotësojnë kushtet e pikës 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës.*

4.2 (ii) **Mbi kursimet nga pagat, deklaruar si burim i krijimit të pasurisë “Apartament 110 m², me adresë: ***, Tiranë.** Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: (i) kursimet e realizuara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortit të saj në vite dhe (ii) pjesërisht me kredi nga ***²⁰.

4.2.1 Komisioni, në vendimin e tij, ka konkluduar: *“në lidhje me këtë pasuri, Komisioni kreu analizën financiare për burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë, duke përllogaritur kursimet e krijuara nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit të saj, të ardhurat nga kredia, si dhe shpenzimet e kryera. Në konkluzion, Komisionit i rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie”²¹.*

4.2.2 Mbi burimin e krijimit: (i) *kursime nga paga*, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues mbi shlyerjen e kësteve të apartamentit²².

¹⁹ Referohuni vendimeve të Kolegjit (JR) nr. 6/2019; Vendimit (JR) nr. 8/2019; (JR) nr. 19/2019; (JR) nr. 27/2019; (JR) nr. 32/2019.

²⁰ Burimi i krijimit: (ii) nga kredia bankare, është trajtuar gjerësisht më sipër nga pika 14 e në vijim.

²¹ Referohuni “Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm”, faqe nr. 11, në vendimin e Komisionit.

²² Në datën **29.4.2013** është depozituar shuma prej 4.310 euro, në llogarinë e noterit, në ***; në datën **17.6.2013**, shuma prej 18.000 euro, në llogarinë e shitësit pranë Bankës ***; në datën **17.3.2014**, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pranë *** është disbursuar kredia në shumën 2.500.000 lekë, e cila (pas zbritjes së komisioneve bankare), në të njëjtën datë, është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë shitëse; në datën **5.8.2013**, shuma 50 euro; në datën **10.6.2014**, shuma 2.000 euro; në

- 4.2.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, hetimi i Komisionit mbi krijimin e depozitave që kanë shërbyer si burim për pagesat e apartamentit, si dhe analizimi i burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë, nuk ka qenë i plotë.
- 4.2.4 Nga verifikimi i dokumentacionit nga bankat e nivelit të dytë mbi llogaritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, rezulton se për disa nga depozitimet (derdhjet *cash*) në depozitat bankare, shuma të cilat më pas kanë shërbyer si burim për blerjen kësaj pasurie, nuk mbulohen tërësisht me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës (sikundër analizuar në ankimin e datës 2.8.2019²³).
- 4.3 *Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se:* do t'i shërbente hetimit administrativ analizimi nga ana e Kolegjit i mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe depozitimet në sistemin bankar, që kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë.

IV. Konkluzione

Mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke disponuar çeljen e hetimit dhe marrjen e provave përkatëse, sipas kërkimeve të ankimit dhe kësaj parashprese.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

datën **25.6.2014**, shuma 1.200 euro; në datën **16.7.2014**, derdhur shuma 20 euro; pagesa në llogarinë e shoqërisë shitëse pranë Bankës ***, ***.

²³ Shuma e depozituar në *cash* në depozitën nr. ***, të çelur në *** Bank, në datën 18.1.2011, prej 2.000 euro, nuk mbulohet me burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, pasi të ardhurat nga paga e subjektit dhe personave të lidhur me të, deri më këtë datë, janë në shumën 274.877 lekë. Deri në momentin e depozitimit të shumës 2.000 euro, në datën 18.1.2011, janë tërhequr nga llogaritë vetëm 126.000 lekë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimin e depozituar në bankë. Në të njëjtën depozitë rezulton se në datën 19.4.2011 është depozituar edhe shuma 5.000 euro, derdhje *cash*. Depozitimet në total deri në datën 19.4.2011, në shumën 7.000 euro, nuk rezultojnë të mbulohen plotësisht me të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për një diferencë negative prej rreth 115.000 lekë, nëse llogarisim në përbërje familjare dhe vjehrrin e subjektit të rivlerësimit ose rreth 252.000 lekë, nëse nuk përfshijmë vjehrrin e subjektit në përbërjen familjare të saj.